

STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 2022-2024

Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë
për periudhën 2022-2024, u miratua nga
Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin
nr. 55, datë 24.11.2021.

Këtë publikim mund ta gjeni në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

1.	MISIONI	5
2.	VIZIONI	6
3.	VLERAT	7
4.	OBJEKTIVAT AFATMEËM	8
4.1	<i>Stabiliteti i çmimeve dhe stabiliteti makroekonomik</i>	8
4.2	<i>Stabiliteti i sistemit financiar</i>	11
4.3	<i>Funksionimi normal i sistemit të pagesave</i>	16
4.4	<i>Nxjerrja dhe qarkullimi i monedhës shqiptare</i>	18
4.5	<i>Administrimi i rezervës valutore</i>	19
4.6	<i>Hartimi dhe shpërndarja e statistikave</i>	20
4.7	<i>Kërkimi shkencor</i>	22
4.8	<i>Mirëqeverisja e institucionit</i>	23

Strategjia Afatmesme e Zhvillimit është një udhërrëfyes për veprimtaritë e Bankës së Shqipërisë gjatë periudhës trevjeçare në vijim. Strategjia identifikon sfidat me të cilat përballet institucioni dhe radhit sipas prioritetit objektivat kryesorë, duke planifikuar edhe veprimtaritë e nevojshme për arritjen e tyre.

Ajo shërben si kornizë orientuese për procesin e buxhetimit në Bankën e Shqipërisë. Procesi i parashikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave të institucionit organizohet në funksion të përmbushjes së detyrave të ngarkuara nga ligji organik dhe të objektivave strategjike.

Miratimi i Strategjisë nga Këshilli Mbikëqyrës, përbën një aspekt të rëndësishëm të rolit të organit më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ky është edhe një element thelbësor i mirëqeverisjes së institucionit, për sa i përket ndarjes së përgjegjësive ndërmjet organeve drejtuese, për vendosjen e prioriteteve, përcaktimin e mjeteve për përmbushjen e tyre dhe monitorimin e performancës së realizuar.

1. MISSIONI

Si banka qendrore e vendit, Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive: (i) të hartimit dhe zbatimit të pavarur të politikës monetare, objektivi kryesor i së cilës – arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve – është kontributi më i mirë që mund të japë politika monetare për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit; (ii) të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, duke siguruar ruajtjen e besimit publik të paraja, përmes garantimit të cilësisë së kartëmonedhave dhe monedhave, dhe plotësimit të sigurt dhe eficient të nevojave të ekonomisë për para; (iii) të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë, si garanci për përballimin e goditjeve të rënda në sektorin real të ekonomisë dhe në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit.

Si emetuese e monedhës kombëtare, Banka e Shqipërisë nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave, duke synuar: qarkullimin e sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët të parasë në ekonomi; parandalimin e rrezikut sistematik; dhe ruajtjen e stabilitetit të institucioneve dhe tregjeve financiare.

Banka e Shqipërisë promovon stabilitetin e sistemit financiar – besimin publik tek institucionet, tregjet dhe infrastruktura financiare – përmes: rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së bankave dhe institucioneve të tjera financiare; identifikimit dhe analizimit të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj stabilitetit financiar; dhe sigurimit të ndërhyrjes së organizuar në bankat me paaftësi paguese, duke minimizuar ndikimin në ekonominë reale dhe financat publike të vendit.

2. VIZIONI

Banka e Shqipërisë synon adoptimin e standardeve të larta të profesionalizimit dhe mirëqeverisjes, për të garantuar përmbushjen e misionit dhe për të nxitur besimin e publikut. Kjo do të realizohet përmes rritjes së:

- a) pavarësisë në përmbushjen e misionit dhe objektivave ligjorë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i përafrimit gradual të legjislacionit dhe politikave tona me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- b) llogaridhënies publike për përmbushjen e detyrave, objektivit kryesor dhe objektivave të tjerë ligjorë të Bankës së Shqipërisë. Kjo përfshin edhe adoptimin e standardeve më të mira të kontabilitetit dhe auditimit, publikimin e raporteve të rregullta financiare, si dhe sigurimin e integritetit të proceseve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, si elemente kyçe të llogaridhënies;
- c) transparencës mbi veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, përmes një komunikimi të hapur dhe të qartë me publikun. Banka e Shqipërisë do të marrë masat e duhura, në përputhje me ligjin dhe politikat e saj, për të rritur kuptueshmërinë dhe parashikueshmërinë e politikës monetare, përmirësuar llogaridhënien dhe forcuar besueshmërinë publike të institucionit.

3. VLERAT

Në funksion të forcimit të besimit publik tek institucioni, veprimtaria e Bankës së Shqipërisë udhëhiqet nga vlerat e mëposhtme.

- a) Integriteti dhe etika: të vepruarit në përputhje me normat ligjore dhe morale, si dhe me standardet më të larta të etikës, duke shmangur çdo ndikim të papërshtatshëm nga ana e palëve të treta, në përmbushjen e detyrave ligjore.
- b) Kompetenca dhe profesionalizmi: të vepruarit me ekspertizën, njohuritë, aftësitë, kualifikimet dhe cilësitë e nevojshme.
- c) Efektiviteti dhe efikasiteti: të vepruarit në mënyrën që rezultatet e dëshiruara të arrihen sa më mirë, duke përdorur burime minimale.
- d) Puna në grup dhe inovacioni: të vepruarit në mënyrë bashkëpunuese, përmes ndihmës reciproke dhe ndarjes së njohurive, si dhe me iniciativë dhe kreativitet në përthithjen e ideve të reja.

4. OBJEKTIVAT AFATMËSËM

Prioritetet në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë përcaktohen në ligjin organik. Në përputhje me objektivin kryesor – arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve – Banka e Shqipërisë nxit dhe mbështet (i) sistemin e këmbimeve valutore, (ii) tregun e brendshëm financiar, (iii) sistemin e pagesave, si dhe (iv) ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit.

Objektivat e tjerë kushtëzohen nga objektivi kryesor dhe nxisin ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar, bazuar në parimet e tregut.

4.1 STABILITETI I ÇMIMEVE DHE STABILITETI MAKROEKONOMIK

Duke siguruar stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë: mundëson ruajtjen e fuqisë blerëse të familjeve shqiptare dhe rrit besimin e tyre në monedhën kombëtare dhe sektorin financiar, kontribuon në marrjen e vendimeve të shëndosha për kursim dhe investime, mbështet krijimin e vendeve të punës dhe ndihmon në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend.

Politika monetare ankorohet në regjimin e shënjestrimit të inflacionit – në një nivel inflacioni prej 3% në afatin e mesëm – dhe mbështetet në një regjim të lirë të kursit të këmbimit.

Prioritetet e politikës monetare për trevjeçarin e ardhshëm janë: (i) përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit të hartimit dhe zbatimit të politikës monetare, në funksion të efektivitetit, eficiencës dhe koherencës në përmbushjen e rolit të saj; (ii) rritja e koordinimit me politikën fiskale dhe makroprudenciale; (iii) nxitja e zhvillimit të tregjeve të brendshme financiare; (iv) përmirësimi i mëtejshëm i transparencës

dhe kuptueshmërisë për publikun; si dhe (v) forcimi i dialogut dhe bashkëpunimit me partnerët vendas e të huaj.

Përbushja e këtyre prioritetëve do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes së politikës monetare.

Strategjia e politikës monetare reflekton rezultatet e arritura, praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe forcat që u japin formë zhvillimeve ekonomike e financiare dhe sfidave të së ardhmes. Një vend të rëndësishëm zënë analiza dhe implementimi i mësimëve nga përballja me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, analiza e implikimeve të inovacionit të vazhdueshëm të tregjeve dhe produkteve financiare, si dhe monitorimi i rreziqeve klimatike për mjedisin ekonomik e financiar ku operon Banka e Shqipërisë.

a. Përmirësimi i kuadrit të politikës monetare

Në funksion të rritjes së efektivitetit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë do të investojë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së analizave ekonomike e financiare, rritjen e saktësisë së parashikimeve dhe plotësimin e tyre me skenarë alternativë dhe/ose rreziku, si dhe vlerësimin e opsioneve të reagimit të politikës monetare dhe identifikimin e alternativave më eficiente.

Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet përmirësimit dhe përditësimit të modeleve të parashikimit dhe analizës së politikës monetare, aplikimit të teknikave bashkëkohore në fushën e modelimit dhe përditësimit të njohurive të personelit me të rejtat më të fundit, si dhe adoptimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në fushat e kërkimit shkencor dhe të vlerësimit empirik të funksionimit të ekonomisë e të tregjeve financiare shqiptare.

b. Rritja e koordinimit me politikat fiskale dhe makroprudenciale

Përmirësimi i eficiencës së politikës monetare kërkon një koordinim të mirë me instrumentet e tjera të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi – politikën fiskale dhe atë makroprudenciale – të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e stimujve monetarë e financiarë dhe në nivelin e kërkesës agregate. Një bashkërendim më i mirë i këtyre politikave synon të gjenerojë rezultate më të mira në drejtim të rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Shkëmbimi i informacionit dhe niveli i dialogut me autoritetet fiskale do të rritet, si dhe do të përmirësohen instrumentet e analizës dhe parashikimit të ndikimit të këtyre politikave në ekonominë dhe në financat publike të vendit.

Në asnjë rast, ky bashkërendim nuk do të cenojë pavarësinë e politikës monetare dhe angazhimin e Bankës së Shqipërisë për të përbushur objektivin e saj kryesor.

c. Nxitja e zhvillimeve të tregjeve të brendshme financiare

Zhvillimi i tregjeve financiare është një element parësor në përmirësimin e mekanizmit të transmetimit dhe në rritjen e eficiencës së politikës monetare. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë (EBRD), do të aplikohet një projekt për diagnostikimin e pengesave për zhvillimin e mëtejshëm të tregut ndërbankar të parasë. Projekti synon vlerësimin e të gjithë aktorëve pjesëmarrës, ose me ndikim, në zhvillimet e tregut ndërbankar të parasë, identifikimin e pikave të dobëta dhe dhënien e rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm, me qëllim përfundimtar përçimin efektiv të politikës monetare.

Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbështesë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në projektin për emetimin e titujve referencë nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut, duke u dhënë përparësi zhvillimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe rritjes së njohurive të punonjësve. Realizimi i këtij projekti do të mundësojë një treg dytësor për titujt likuid, konkurrent dhe transparent.

Brenda vitit 2022, do të mbyllet gradualisht aktiviteti i ndërmjetësimit në blerjen dhe administrimin e llogarive të titujve të Qeverisë Shqiptare për klientët individë, duke ua kaluar këtë aktivitet tërësisht bankave.

Në funksion të përmirësimit të transmetimit të politikës monetare, lista e produkteve financiare që u ofrohen bankave do të zgjerohet me marrëveshjet SWAP dhe ekzekutimin e ankandëve të shitblerjes së valutës edhe në tregun FORWARD, krahas atij SPOT.

d. Përmirësimi i komunikimit me publikun

Një komunikim i hapur dhe i drejtpërdrejtë me publikun që shpjegon thjesht dhe qartë arsyet pas çdo vendimmarrjeje, u ofron agjentëve ekonomikë informacionin e nevojshëm për të marrë vendimet e duhura, në kohën e duhur, redukon pasiguritë ekonomike e financiare dhe rrit efektivitetin e politikës monetare.

Informacioni i publikuar do të pasurohet me të dhëna të reja dhe me parashikime, gjë që do të rrisë kuptueshmërinë e vendimmarrjes, si dhe llogaridhënien publike të Bankës së Shqipërisë.

e. Forcimi i bashkëpunimit me partnerët

Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbështesë dhe këshillojë reformat e gjithanshme strukturore të vendit, duke përbushur detyrën e saj ligjore si këshilltar për politikën që prekin treguesit dhe/ose sistemin financiar shqiptar. Në veçanti, bashkëpunimi me autoritetin fiskal do të konsolidohet më tej, në funksion të hartimit të dokumenteve strategjike të zhvillimit ekonomik.

f. Rritja e fleksibilitetit të instrumenteve

Banka e Shqipërisë do të vijojë të vlerësojë efektivitetin e instrumenteve të politikës monetare në dispozicion, përfshirë edhe ato që klasifikohen si masa jokonvencionale, me synim përdorimin e tyre, në rast nevojë, për arritjen e objektivit të saj kryesor.

Rritja e fleksibilitetit në përdorimin e instrumenteve konvencionale apo jokonvencionale, mundëson adresimin e sfidave të reja me përqaqjet e duhura, duke ndihmuar në përmbushjen e rolit të politikës monetare.

4.2 STABILITETI I SISTEMIT FINANCIAR

Stabiliteti financiar konceptohet si aftësia e sistemit financiar (institucioneve, tregjeve dhe infrastrukturës përkatëse) për të kryer me eficiencë ndërmjetësimin financiar dhe funksionet e tjera, në kushte normale dhe në situata ekonomike më të pafavorshme. Ruajtja e stabilitetit financiar kërkon parandalimin e rreziqeve me rëndësi sistemike, si dhe rritjen e rezistencës së sistemit financiar dhe sektorit bankar ndaj tyre.

4.2.1 POLITIKA MAKROPRUDENCIALE

Nisur nga detyrat e veta ligjore dhe në kushtet kur sektori bankar mbizotëron në sistemin financiar shqiptar, Banka e Shqipërisë luan një rol parësor në zbatimin e politikës makroprudenciale. Ky rol evidentohet në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Banka e Shqipërisë do të angazhohet në vlerësimin, monitorimin dhe identifikimin e veprimeve për trajtimin e rreziqeve të sistemit financiar, me fokus të veçantë rrezikun sistematik dhe sektorin bankar. Aty ku është e nevojshme, mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare e në procedurat në fuqi, kjo veprimtari do të kryhet në bashkëpunim me autoritetet e tjera publike.

Gjatë periudhës afatmesme synohet:

- a. forcimi i rolit të Bankës së Shqipërisë në kuadër të politikës makroprudenciale, përmes vendosjes së përcaktimeve të qarta ligjore, në përputhje me standardet ndërkombëtare (brenda vitit 2024);
- b. përmirësimi i proceseve të zbatimit të politikës makroprudenciale: (i) pasurimi i instrumenteve makroprudenciale që synojnë rreziqet sistemike strukturore, përfshirë miratimin e kuadrit nënligjor për instrumentet që vendosen mbi

huamarrësin (brenda vitit 2022) dhe operacionalizimin e zbatimit të mundshëm të shtesës makroprudenciale të kapitalit për rrezikun sistemik (brenda vitit 2023), dhe (ii) ushtrimi i provës së rezistencës për qëllime makroprudenciale, përfshirë ndjeshmërinë ndaj ndërlidhjes së sektorit bankar me sektorë të tjerë të sistemit financiar dhe ekonomisë (brenda vitit 2022);

- c. kryerja e një vlerësimi për ndikimin e rreziqet që ndryshimet e klimës mund të sjellin mbi veprimtarinë bankare e financiare dhe instrumentet e mundshme për adresimin e tyre (brenda vitit 2023);
- d. përmirësimi i publikimeve që trajtojnë çështje të stabilitetit financiar dhe të politikës makroprudenciale.

4.2.2 SIGURIA DHE SHËNDETI I SISTEMIT BANKAR

Përmes licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare, Banka e Shqipërisë synon ruajtjen e besimit në sistemin bankar, mbrojtjen e depozituesve, nxitjen e disiplinës së tregut dhe të konkurrencës së ndershme, si dhe garantimin e një veprimtarie të shëndoshë të institucioneve bankare e financiare. Të gjitha këto kontribuojnë në forcimin e stabilitetit financiar në vend.

a. Përafrimi i kuadrit mbikëqyrës me standardet evropiane dhe globale

Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të kapitalit dhe likuiditetit të Bazel III dhe të akteve të tyre implementuese në Bashkimin Evropian (rregullorja dhe direktiva për kërkesat e kapitalit), synon forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar, për të qenë në një pozicion sa më të mirë për përthithjen e goditjeve. Kjo synon, gjithashtu, që bankat të vazhdojnë të financojnë aktivitetin dhe rritjen ekonomike.

Në fokus të periudhës afatmesme janë:

- përditësimi i kuadrit rregullator për likuiditetin dhe mjaftueshmërinë e kapitalit, për sa u përket rreziqeve të shtyllës së parë – rreziku i kredisë, rreziku i tregut dhe rreziku operacional – sipas kërkesave të Bazel III, dhe rrezikut të normës së interesit në librin e bankës;
- rishikimi i kërkesave në fuqi të shtyllës së dytë për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (perspektiva normative dhe ekonomike) dhe miratimi i kërkesave rregullatore për procesin e brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit për bankat; dhe
- plotësimi i kuadrit licencues e mbikëqyrës të administrimit të rrezikut në veprimtarinë e institucioneve të pagesave dhe të institucioneve të parasë elektronike, në zbatim të kërkesave të Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

b. Konsolidimi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik

Implementimi i zhvillimeve të nevojshme metodologjike e operacionale, me asistencën e institucioneve partnere ndërkombëtare, synon të sigurojë një kalibrim më të mirë të kërkesave për kapital të diferencuar, në përputhje me profilin e rrezikut të çdo banke.

Zhvillimet e reja metodologjike do të aplikohen paralelisht me metodologjitë ekzistuese për një periudhë kalimtare 3-vjeçare. Me miratimin e metodologjisë së re, cilësia e qeverisjes/drejtimin të bankave do t'u nënshtrohet kërkesave të përmirësuara mbikëqyrëse.

c. Rritja e bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes

Ndërthurja e aktivitetit të bankave me subjektet jobanka dhe me aktivitete financiare jashtë sferës së mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, kërkon forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të tregut financiar shqiptar.

Bashkëpunimi me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave do të forcohet, duke u përqendruar në kryerjen e ekzaminimeve të përbashkëta në subjektet e mbikëqyrura.

Në zbatim të marrëveshjes së mirëkuptimit me Bankën Qendrore Evropiane, do të vazhdojë pjesëmarrja në kolegjet mbikëqyrëse të bankave të grupeve të rëndësishme bankare evropiane. Gjithashtu, do të synohet nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me banka të tjera qendrore.

d. Rregullimi i administrimit të kredive me probleme

Kreditë me probleme (KMP) ndikojnë negativisht aftësinë e bankave për të kredituar ekonominë. Banka e Shqipërisë synon hartimin e një udhëzuesi për adresimin e hershëm dhe shterues të problematikave të portofolit me probleme, në funksion të adresimit të stokut aktual dhe parandalimit të akumulimit të KMP-ve të reja në bilancet e bankave. Kjo synon kryesisht reduktimin e kredive me probleme në bilancet e bankave, duke i orientuar ato për administrimin efektiv të këtyre kredive. Udhëzuesi do të bazohet në përfaqshjen e trajtimit të kredive me probleme në Evropë, përvojën e deritanishme shqiptare dhe specifikat e tregut vendas.

e. Përmirësimi i vlerësimit të cilësisë së vendimmarrjes në kredidhënien bankare

Kapacitetet mbikëqyrëse do të pasurohen me vënien në zbatim të një sistemi vlerësimi për aftësinë huamarrëse të bizneseve, i ndërtuar me asistencën e institucioneve homologe evropiane. Ky sistem synon të vlerësojë cilësinë financiare të bizneseve krahasuar me tregues referencë ndaj të gjithë huamarrësve, në varësi të ecurisë së marrëdhënieve së tyre të kredisë me bankat në vend. Kjo do t'i shërbejë vlerësimin të cilësisë së portofolave të kredive dhe ndërtimit të parametrave të vlerësimin e provigjionimit kontabël, në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

f. Rishikimi i kuadrit raportues

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar do të zbatohen ndaj subjekteve bankare. Kjo kërkon rishikimin e të gjithë procesit të raportimit të pasqyrave financiare të bankave, për të qenë në përputhje edhe me standardet e vendosura nga organet mbikëqyrëse evropiane. Banka e Shqipërisë do të bëjë ndryshimet e nevojshme rregullative për përshtatjen me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, duke ruajtur parametrat mbikëqyrës në serinë kohore të të dhënave të raportuara.

4.2.3 NDËRHYRJA E JASHTËZAKONSHME NË BANKA

Në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë siguron një ndërhyrje të organizuar në bankat me paaftësi paguese, duke minimizuar ndikimin e tyre në ekonominë reale, financat publike dhe stabilitetin financiar të vendit.

Objektivat ligjorë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë: (i) të sigurojë vazhdimësinë e funksioneve kritike të bankës; (ii) të shmangë çdo pasojë të rëndë negative për stabilitetin e sistemit financiar, duke parandaluar përhapjen e rreziqeve, përfshirë edhe infrastrukturën e tregut, dhe duke ruajtur disiplinën e tregut; (iii) të mbrojë fondet publike, duke minimizuar mbështetjen financiare publike të jashtëzakonshme; (iv) të mbrojë depozituesit e siguruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave; dhe (v) të mbrojë fondet dhe aktivet e tjera të klientëve. Gjatë periudhës afatmesme, Banka e Shqipërisë do të fokusohet në këto drejtime kryesore:

a. Cikli vjetor i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Banka e Shqipërisë përditëson çdo vit planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për secilën bankë. Për periudhën 2022-2024, plani vjetor do të fokusohet në fuqizimin e vazhdueshëm të aftësisë së sektorit bankar për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Në funksion të identifikimit dhe trajtimit të pengesave të mundshme ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, do të hartohen plane veprimi për secilën bankë, që përfshijnë:

- fuqizimin e kuadrit të qeverisjes në drejtim të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- identifikimin e burimeve njerëzore kritike për vijueshmërinë e aktivitetit kryesor;
- përshtatshmërinë e sistemit të administrimit të informacionit për realizimin efektiv të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
- hartimin e planeve të kontigjencës për mbështetjen operacionale e financiare të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të planeve përkatëse të komunikimit; dhe
- përmbushjen e vazhdueshme të kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar.

Banka e Shqipërisë do të monitorojë e mbështesë fuqizimin e aftësisë së bankave për ndërhyrje të jashtëzakonshme, përmes një komunikimi aktiv dhe inspektimeve të rregullta, me qëllim operacionalizimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas kërkesave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

b. Kërkesat minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar

Bankat do të përditësojnë rregullisht metodologjinë e përcaktimit të kërkesës minimale, duke marrë në konsideratë kërkesën për kapital në fuqi gjatë secilit vit dhe periudhën kalimtare, deri në përmbushjen përfundimtare të kërkesës minimale. Sektori bankar do të përmbushë gradualisht kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar, gjatë periudhës 2022-2027.

c. Trajtimi i pengesave ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Hartimi i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat që ushtrojnë veprimtari në Shqipëri ka përfunduar. Secilës bankë do t'i komunikohet një përmbledhje ekzekutive e planit përkatës, për adresimin e të gjitha pengesave të mundshme ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme të identifikuar në plan.

Brenda vitit 2022, çdo bankë do të kryejë një proces vetëvlerësimi të aftësisë së saj për të zbatuar me efektivitet planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe për të trajtuar pengesat potenciale të identifikuar, bazuar në objektivat e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme të përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi. Vetëvlerësimi do të përfshijë edhe rekomandimet e Bankës së Shqipërisë të identifikuar gjatë komunikimit vjetor me bankën dhe inspektimit në vend.

Gjatë periudhës 2023-2024, Banka e Shqipërisë do të përcaktojë programin individual të punës për trajtimin e pengesave të mundshme për secilën bankë. Masat e marra nga bankat për eliminimin e pengesave të identifikuar dhe përditësimin e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme do të monitorohen në vazhdimësi.

d. Përditësimi i kuadrit rregullator e metodologjik

Praktikat në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme do të harmonizohen me zhvillimet në legjislacionin e Bashkimit Evropian. Banka e Shqipërisë do të përditësojë rregullisht metodologjinë teknike vjetore të përcaktimit të kërkesës minimale, sipas përqasjes së publikuar nga Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në nivel evropian.

e. Monitorimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme

Përlllogaritja e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe e kontributeve vjetore të bankave për plotësimin e këtij niveli, do të përditësohen çdo vit. Monitorimi i administrimit të mjeteve financiare të Fondit do të vijojë në përputhje me politikën e investimit të miratuar në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

f. Forcimi i kapaciteteve njerëzore e logjistike

Banka e Shqipërisë angazhohet në forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me autoritetet homologe evropiane, përmes marrëveshjeve që mundësojnë pjesëmarrje në takime, seminare dhe kolegje të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në funksion të përmirësimit të cilësisë së informacionit dhe ndarjes së përvojës institucionale.

Gjatë periudhës afatmesme në vijim, parashikohet automatizimi i mëtejshëm i proceseve të punës që lidhen me rritjen e eficiencës dhe përmirësimin e kontrollove të brendshme; në mënyrë të veçantë ato që lidhen me të dhënat e raportuara nga sektori bankar për hartimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

4.3 FUNKSIONIMI NORMAL I SISTEMIT TË PAGESAVE

Duke siguruar funksionimin normal të sistemit të pagesave, *Banka e Shqipërisë synon qarkullimin e sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët, të parasë në ekonomi, parandalimin e rrezikut sistemik dhe ruajtjen e stabilitetit të institucioneve e tregjeve financiare.*

Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave do të realizohet nëpërmjet:

- a. Operimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të sistemeve të pagesave, në bazë të nevojave të tregut

Banka e Shqipërisë synon operimin e sigurt dhe efikas të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe (AIPS – *Albanian Interbank Payment System*) dhe sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH – *Albanian Electronic Clearing House*).

Për këtë qëllim, gjatë periudhës afatmesme synohet:

- zbatimi i risive rregullative dhe infrastrukturore të ndërmarra, si: (i) operacionalizimi i skemës së Debitimit Direkt, (ii) zgjerimi i pjesëmarrjes në sistemet e pagesave për aktorët e rinj në treg, dhe (iii) operacionalizimi i shlyerjes së pagesave në euro brenda vendit;
- forcimi i bashkëpunimit me Komitetin Kombëtar të Sistemeve të Pagesave;
- rritja e bashkëpunimit me Bankën Botërore, Sistemin Evropian të Bankave Qendrore dhe me bankat e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

- b. Rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së sistemit të pagesave dhe të elementeve të rëndësishme të tij, duke përfshirë nxitjen e mirëfunksionimit të instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël, do të punohet për:

- konsolidimin e një mjedisi rregullator lehtësues për pagesat me vlerë të vogël dhe implementimin në praktikë të Ligjit për Shërbimet e Pagesave;
- përmirësimin e aksesit të individëve në llogaritë bankare, përmes adoptimit të Direktivës së Bashkimit Evropian për llogaritë e pagesave. Banka e Shqipërisë synon: (i) t'i ofrojë çdo personi të drejtën për një llogari bazike pagese, pavarësisht vendbanimit apo gjendjes financiare; (ii) të përmirësojë transparencën e tarifave të këtyre llogarive dhe konkurrencën në treg, duke zgjeruar databazën qendrore mbi komisionet për shërbimet e pagesave; dhe (iii) të lehtësojë kalimin e llogarive nga një bankë te tjetra.

Projektet e mësipërme po zbatohen me asistencën teknike të Bankës Botërore, financiar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), si dhe bashkëpunëtorë të tjerë ndërkombëtarë.

Banka e Shqipërisë do të vijojë përpjekjet për konsolidimin e funksionit mbikëqyrës për sistemet e shlyerjes së titujve dhe bashkëpunimin me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për këtë qëllim.

c. Promovimit të eficiencës në sistemin e pagesave

Banka e Shqipërisë synon krijimin e një tregu bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe efikase, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh e shërbimesh pagesash që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht, në të gjithë vendin.

Një rol të rëndësishëm luan dhe Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave dhe Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël. Për këtë, Banka e Shqipërisë:

- do të vijojë punën për zbatimin e strategjisë dhe organizimin e takimeve dhe aktiviteteve të tjera, ku përfshihet edhe nxitja e edukimit financiar;
- do të mbështesë aktorët e tregut përmes studimeve dhe konsultimeve në lidhje me zhvillimin e infrastrukturave kombëtare dhe/ose rajonale për shlyerjen e pagesave të shpejta; dhe
- do të koordinojë nismat e tjera ndërinstucionale që ndërthuren me objektivat dhe masat e marra nga Komiteti.

4.4 NXJERRJA DHE QARKULLIMI I MONEDHËS SHQIPTARE

Banka e Shqipërisë synon ruajtjen e besimit publik të para, përmes garantimit të cilësisë së kartëmonedhave e monedhave në qarkullim dhe plotësimin të sigurt e eficient të nevojave të ekonomisë për para, në vlerë dhe strukturë.

Për periudhën 2022-2024, Banka e Shqipërisë synon:

- a. Plotësimin e nevojave të ekonomisë për para të gatshme dhe të përshtatshme për qarkullim

Studimi në vijimësi i nevojave në rritje të ekonomisë për para të gatshme e të përshtatshme për qarkullim është fokusi kryesor në periudhën afatmesme në vijim. Kjo do të arrihet përmes:

- ndjekjes, me baza mujore, të gjendjes së sasisë së parasë së gatshme (fonde logjistike dhe strategjike), krahasuar me kërkesën e ekonomisë për para, në situata normale dhe të jashtëzakonshme;
 - plotësimin të prodhimit të kartëmonedhave me dizenjo të përmirësuar dhe hedhjes së tyre në qarkullim gjatë vitit 2022.
- b. Përmirësimin e cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim, nëpërmjet rritjes së efektivitetit dhe kapacitetit në veprimtarinë përpunuese

Garantimi i cilësisë së kartëmonedhave synon ruajtjen e integritetit të kartëmonedhës

për publikun përdorues, dhe ruajtjen e një imazhi dinjitoz të Bankës së Shqipërisë dhe të Shtetit Shqiptar. Ky objektivi do të realizohet përmes:

- përshtatjes së vazhdueshme të teknikës dhe teknologjisë për të siguruar procese të automatizuara dhe sisteme bashkëkohore për përpunimin, paketimin dhe shkatërrimin e të kartëmonedhave në qendrat e *cash-it*;
- kontrollit të përhershëm dhe nxitjes së sistemit bankar për përdorimin e sistemeve të pranimit dhe përpunimit të kartëmonedhave të certifikuara dhe të autorizuara nga Banka e Shqipërisë.

c. Mbrojtjen nga falsifikimi

Mbrojtja nga falsifikimi synon ruajtjen dhe rritjen e besimit të publikut të monedha shqiptare. Ky objektivi sigurohet nëpërmjet:

- studimit dhe përmirësimit të elementeve të sigurisë së kartëmonedhës;
- përmirësimit të vazhdueshëm të kapaciteteve dhe aftësive të personelit, nëpërmjet trajnimeve, kualifikimeve dhe pjesëmarrjes në seminare dhe *workshope*, në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së monedhave nga falsifikimi;
- rritjes së bashkëpunimit në fushën e luftës kundër falsifikimit, duke formalizuar marrëveshje me autoritetet kombëtare për këtë qëllim;
- organizimit të seminareve informuese dhe orientuese, me punonjës të sistemit financiar, mbi elementet e sigurisë së kartëmonedhave dhe faktorët që minimizojnë falsifikimin e tyre.

d. Përmirësimin e administrimit fizik të vlerave monetare

Banka e Shqipërisë do të forcojë praktikën e kontrollit fizik që garantojnë sigurinë dhe pacenueshmërinë e vlerave monetare që administrojnë, në funksion të emisionit e thesarit, dhe në përputhje me praktikën më të mira të fushës, përmes:

- rishikimit, sa herë që është e nevojshme, të rregullave e procedurave të administrimit të vlerave, me qëllim përsosjen e tyre dhe sigurimin e standardeve më të larta;
- përmirësimit të sistemeve kompjuterike të administrimit të vlerave;
- përmirësimit të kushteve dhe mjediseve të depozitimit dhe ruajtjes së vlerave.

4.5 ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Banka e Shqipërisë miraton e zbaton politikën e kursit të këmbimit dhe administrojnë rezervën valutore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Administrimi i rezervës valutore synon të sigurojë:

- a. plotësimin e nevojave për likuiditet në monedhë të huaj të lidhura me: zbatimin dhe mbështetjen e politikës monetare dhe asaj të kursit të këmbimit, ruajtjen e stabilitetit financiar apo mbulimin e nevojave të vendit në periudhë krize;
- b. ruajtjen e fondit të rezervës, në tërësinë e tij, nëpërmjet mbajtjes nën kontroll në një mënyrë sa më të kujdesshme, të rrezikut të likuiditetit, të tregut, të kreditit, ligjor, të shlyerjes, të kujdestarisë dhe atij operacional;
- c. gjenerimin e të ardhurave të arsyeshme në periudhën afatmesme në afatgjatë, në përputhje me objektivat e investimit dhe administrimit të rreziqeve, për sa kohë që kjo nuk bie ndesh me kriteret e likuiditetit dhe sigurisë të përcaktuara më sipër.

Në funksion të një administrimi më të mirë të rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon diversifikimin e instrumenteve të investimit, duke përfshirë: (i) MBS (*mortgage backed security*); (ii) *Reverse REPO*; (iii) instrumentet ESG (*environmental, social and governance investing*); dhe (iv) ILB (*inflation linked bonds*).

Realizimi i këtij objekti do të kërkojë:

- a. vijueshmërinë e trajnimit të personelit dhe shkëmbimin e përvojës me institucionet homologe dhe bankat tregtare partnere;
- b. një program/sistem të ri për administrimin e portofolit të rezervës valutore, në përshtatje me nevojat për një diversifikim të portofolit përmes shtimit të klasave të reja të instrumenteve financiare. Ky sistem do të sigurojë administrimin, matjen dhe raportimin e rreziqeve që mbarten, apo të rezultateve/të ardhurave që krijohen gjatë investimit të portofolit;
- c. përditësimin e vazhdueshëm të bazës rregullative, në përputhje me alternativat e reja në investim dhe nevojën për adresimin e rreziqeve, si dhe këshillim ligjor të jashtëm për marrëveshjen model *Global Master Repurchase Agreement* me bankat për instrumentet *REPO*.

4.6 HARTIMI DHE SHPËRNDARJA E STATISTIKAVE

Banka e Shqipërisë synon të paraqesë në publik statistika të plota që përputhen me standardet ndërkombëtare dhe shërbejnë si bazë për zbatimin e politikës monetare, politikës makro dhe mikroprudenciale.

Funksioni statistikor është një faktor i rëndësishëm në procesin e hartimit të politikave dhe vendimmarrjes, si dhe komunikimit e monitorimit të efektivitetit të tyre. Statistikat janë thelbësore për transparencën e besueshmërinë e Bankës së Shqipërisë dhe besimin e publikut në të.

Objektivat kryesorë në fushën e përgatitjes dhe shpërndarjes së statistikave janë:

- a. Përafrimi metodologjik i statistikave me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin evropian

Ky objektivi do të realizohet përmes:

- adoptimit të standardeve të Bashkimit Evropian mbi përgatitjen e agregatëve monetarë dhe të treguesve të stabilitetit financiar (raportimi i zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe institucioneve monetare dhe financiare; statistikave mbi asetet dhe detyrimet e fondeve të investimeve; kërkesat e raportimit statistikor për kompanitë e sigurimeve; kërkesat e raportimit statistikor për fondet e pensionit);
- përmirësimit të kornizës ligjore (dhe aspekteve të cilësisë) për mbledhjen e të dhënave mbikëqyrëse, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave mbikëqyrëse për bankat, në përputhje me standardet zbatuese teknike për raportimin rregullator të Autoritetit Bankar Evropian.

Raportimi prudencial i bankave në Bankën e Shqipërisë dhe adoptimi i kornizës së përbashkët të raportimit të standardizuar të raportimit financiar në Evropë (FINREP), sipas standardit të Autoritetit Bankar Evropian, do të mundësojnë:

- krijimin e një baze të gjerë të dhënash bankare për administrimin më të mirë të rreziqeve përmes subjekteve të mbikëqyrura;
 - lehtësimin e rishikimeve, parashikimeve të ecursisë dhe analizës së rrezikut për një transparencë më të madhe mbi akumulimin e rrezikut në industrinë bankare;
 - shkëmbimin e informacionit me autoritetet e tjera, brenda dhe jashtë vendit, për institucionet me operacione ndërkufitare;
 - përputhshmëri të plotë të raporteve rregullatore dhe standardeve teknike të prodhimit statistikor me kërkesat e Komisionit Evropian. Platforma do të mbështetet në gjuhën e standardizuar të përpunimit dhe raportimit të detyrueshëm të bankave qendrore në Autoritetin Bankar Evropian dhe në Bankën Qendrore Evropiane.
- b. Rritja e cilësisë dhe integritetit të statistikave për informimin e politikëbërjes dhe shpjegimin e zhvillimeve në tregjet financiare

Zhvillimi i një sistemi të integruar të të dhënave lidhet me angazhimin për mirëqeverisjen e funksionit statistikor. Ky sistem do të mundësojë administrimin e integruar, efikas dhe të sigurt të të dhënave që mbledhen dhe shpërndahen nga Banka e Shqipërisë.

4.7 KËRKIMI SHKENCOR

Banka e Shqipërisë synon të përgatisë studime cilësore ekonomike në fushat e saj të interesit, duke kontribuar në njohjen e ekonomisë shqiptare dhe të proceseve ekonomike, financiare, shoqërore dhe politike që e ndikojnë atë.

Objektiv kryesor i kërkimit shkencor është integrimi i rezultateve të studimeve ekonomike e analizave empirike në vendimmarrjen e politikës monetare, stabilitetit financiar, mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut financiar, si dhe në aspekte të tjera të bankingut qendror.

Puna kërkimore do të fokusohet në hulumtimin e fenomeneve të reja për akademinë dhe bankat qendrore – ndryshimet klimatike, goditjet nga fatkeqësitë natyrore/pandemitë, zhvillimet demografike, dixhitalizimi, politikat e bilancit – dhe efektet e tyre në ekonomi e në sistemin financiar, për të kuptuar rreziqet që ato mbartin dhe implikimet e tyre në funksionet e Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimi i modeleve të dedikuara për hulumtimin dhe interpretimin e efekteve të këtyre fenomeneve në ekonominë shqiptare, ka si objektiv shndërrimin e tyre në platforma të analizës dhe orientimit të vendimmarrjes së politikës monetare dhe të stabilitetit financiar.

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të aplikojë metodologji bashkëkohore për testimin e hipotezave dhe vlerësimin e efekteve të fenomeneve ekonomike e financiare, të jashtme e të brendshme, në funksion të parashikimit dhe të vendimmarrjes së saj.

Në aspektin metodologjik, implementimi i modeleve me parametra të luhatshme në kohë dhe i metodologjive të kërkimit të bazuara në platformat “Big Data” e të inteligjencës artificiale “e-Machine Learning”, synon aplikimin e tyre në përpunimin dhe analizën e informacionit statistikor makro e mikroekonomik. Bazat e të dhënave statistikore do të pasurohen me informacion për studimin e sjelljes së familjeve e bizneseve, si dhe të ndërveprimit të tyre me vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë.

Kapacitetet dhe dobishmëria e projekteve kërkimore do të rritet, duke nxitur diskutimin dhe produktet e kërkimit, përmes:

- bashkëpunimit me akademinë dhe veprimtarive të përbashkëta, kombëtare e ndërkombëtare;
- rritjes së përmbajtjes akademike të veprimtarive kërkimore, si Seminari i të Premtes, *Workshop*-i i Kërkimeve dhe konferencat shkencore;
- publikimit të punës shkencore në revista ndërkombëtare, me reputacion në fushën e ekonomisë dhe financës.

4.8 MIRËQEVERISJA E INSTITUCIONIT

Banka e Shqipërisë synon forcimin e mëtejshëm të mirëqeverisjes, përmes rritjes së pavarësisë institucionale, transparencës dhe llogaridhënies, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i përafrimit gradual me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Banka e Shqipërisë synon të ketë në dispozicion burime të mjaftueshme njerëzore, fizike dhe financiare, për të përmbushur objektivat e saj ligjorë e strategjike, duke i kushtuar vëmendje të veçantë politikave të marrëdhënieve të punësimit, kualifikimit dhe zhvillimit të karrierës të personelit.

Zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve njerëzore për garantimin e shërbimeve dhe adresimin e sfidave të reja, përfshin: (i) përvetësimin e praktikave më të mira të administrimit të burimeve njerëzore; (ii) promovimin e një kulture pune të mbështetur në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojës profesionale; dhe (iii) ofrimin e trajnimit cilësor për implementimin e proceseve/metodave të reja të punës.

Në funksion të zbrërthimit të kësaj strategjie në plane financiare vjetore e afatmesme, do të përmirësohen proceset për miradministrimin e aktiveve dhe burimeve financiare, në përputhje me parashikimet buxhetore dhe kuadrin rregullativ. Praktikrat e ndjekura do të zhvillohen më tej, duke shfrytëzuar eksperiencat më të mira dhe asistencën teknike të misioneve të FMN-së.

Banka e Shqipërisë synon hartimin dhe publikimin e pasqyrave financiare që paraqesin në mënyrë të drejtë situatën financiare të institucionit, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo kërkon zbatimin e politikave kontabël të përshtatshme për institucionin. Gjatë periudhës afatmesme në vijim, do të reflektohen ndryshimet në SNRF-të ekzistuese dhe standardet e reja në politikat kontabël dhe në implementimin e tyre. Personeli do të përditësohet me zhvillimet e reja në standardet e kontabilitetit dhe interpretimin e tyre nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Manuali i Kontabilitetit do të rishikohet, për të ofruar një kornizë të plotë të kuadrit të Politikave të Kontabilitetit që ndihmon në interpretimin dhe zbatimin e politikave kontabël në përputhje me SNRF-të, brenda kontekstit të operacioneve/transaksioneve të Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë synon të rrisë efektivitetin në procedurat e prokurimit, të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve dhe të ulë shpenzimet e veta procedurale. Në fokus të investimeve të Bankës së Shqipërisë do të jetë ndërtimi i objektit të ri për nevojat e Departamenti të Emisionit, sipas projektimit të hartuar nga personeli i Bankës së Shqipërisë dhe projektzbatimit të prokuruar.

Teknologjia e informacionit do të fokusohet në: (i) zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit, optimizimin dhe virtualizimin e pajisjeve qendrore për administrim, kosto dhe shërbime të përmirësuara, si dhe adoptimin e teknologjive të reja për mbrojtjen e mjedisit dhe eficiencën në energji; (ii) shtimin e shërbimeve dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemeve të shlyerjes dhe pagesave, si dhe të sistemeve të tjera të brendshme; (iii) automatizimin e proceseve për rritjen e cilësisë, performancës dhe sigurisë; (iv) modernizimin e mëtejshëm të mbledhjes e përpunimit të të dhënave statistikore; dhe (v) forcimin e sigurisë, mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, mbrojtjen kibernetike dhe implementimin e ndryshimeve në programin e sigurisë së shërbimit SWIFT-CSP (*Customer Security Program*).

Në përmbushjen e objektivave strategjike, Sistemi i Kontrollit të Brendshëm luan një rol të rëndësishëm, duke kontribuar në efektivitetin e institucionit, respektimin e politikave të drejtimit, ruajtjen e mjeteve, parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve/gabimeve, saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve kontabël, si dhe përgatitjen në kohë të informacionit të besueshëm financiar.

Banka e Shqipërisë do të punojë për: (i) zbatimin e planit të masave për implementimin e rekomandimeve të vlerësimit të cilësisë së auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, për pajtueshmërinë e plotë dhe përditësimin e vazhdueshëm të bazës rregullative, në koherencë me standardet ndërkombëtare të fushës; (ii) rritjen e pavarësisë e cilësisë së auditimit të brendshëm, përmes forcimit të linjave të raportimit të Këshilli Mbikëqyrës dhe Komiteti i Auditit, si dhe të kapaciteteve njerëzore nëpërmjet rekrutimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional; dhe (iii) ndërgjegjësimin e personelit mbi funksionimin e Tre Linjave të Mbrojtjes në administrimin dhe kontrollin efektiv të rrezikut.

Roli i Komitetit të Auditit do të forcohet në drejtim të: (i) integritetit të procesit të raportimit financiar; (ii) mjaftueshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm; (iii) performancës së funksioneve të auditimit të brendshëm e të jashtëm dhe administrimit të rrezikut operacional; si dhe (iv) përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator. Kjo do të mundësojë një fokus më të thelluar dhe efektivitet më të lartë të Këshillit Mbikëqyrës në trajtimin e çështjeve të lidhura me transparencën dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë.

Administrimi i Rrezikut Operacional (ARO) do të fokusohet në: (i) rritjen e kulturës së rrezikut; (ii) integrimin e ARO-s me funksionet e njërive dhe përditësimin e proceseve bazuar në ngjarjet e ndodhura; (iii) përmirësimin e procesit të raportimit mbi rrezikun nga ana e njërive, në plotësi, cilësi e kohë, si dhe të raportimit për efektivitetin e planeve të veprimit për reduktimin e rrezikut operacional; dhe (iv) integrimin e rezultateve të ARO-s në planifikimin strategjik.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërgjegjësimit, mbështetjes së vazhdueshme dhe nxitjes së sinjalizimit të veprimeve ose praktikave të dyshuara si korruptive, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Programi i Menaxhimit të Vijueshmërisë së Veprimtarisë (MwV) do të plotësohet dhe testohet në vazhdimësi, me qëllim rritjen e aftësive strategjike e taktike për të planifikuar, dhe për t'iu përgjigjur në kohë ngjarjeve, krizave operacionale dhe ndërprerjeve të veprimtarisë, pa cenuar vijimin e veprimtarisë. Analiza e Impaktit në Veprimtari do të pasurohet përmes identifikimit të aktiviteteve kritike sipas ndikimit të ndërprerjes, ndërvarësive, treguesve të vijueshmërisë, infrastrukturës mbështetëse dhe burimeve të nevojshme për sigurimin e vijueshmërisë dhe/ose rimëkëmbjes së tyre në kohë.

